



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.37.1-2012-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË ZYRËS ADMINISTRATIVE TË
MITROVICËS VERIORE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012

Prishtinë, Qershor 2013

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Opinionin dhe raportin i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri mbështetur nga Stana Dancetovic (Udhëheqës i ekipit), Svetlana Perovic dhe Nebojsa Ristic.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat vjetore financiare	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak	9
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	9
5 Sistemi i auditimit të brendshëm	18
6 Konkluzioni i përgjithshëm	19
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	20

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-të) për vitin 2012 për Zyrën Administrative të Mitrovicës Veriore (ZAMV). Dëshiroj ta falënderoj Zyrtaren Kryesore Ekzekutive dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ne kemi kryer auditimin e PVF për vitin 2012 në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me PVF.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- PVF;
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit); dhe
- Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Opinion

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit për opinionin e tij në formatin e përcaktuar në nën kapitullin 2.3 – Opinioni i Auditimit. Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e ZAP. Raporti i AP-së përfshin një opinion për vërtetësinë dhe drejtësinë e PVF.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Si *Theksim i çështjes* Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm. Regjistri i pasurive fikse nuk ka ndikim në ndonjëren prej 2 Pasqyrave Vjetore Financiare (Pranimet dhe Pagesat e Parasë së Gatshme dhe Krahasimin e Buxhetit dhe Shumat Aktuale), në pajtim me IPSAS në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme. **(SNISA: 400 Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes)**

Konkluzioni i përgjithshëm

Niveli i punës së ndërmarrë nga ana e ZAP për të përfunduar auditimin e vitit 2012 është pasqyrim i drejtpërdrejtë i cilësisë së mjedisit të kontrollit të brendshëm të implementuar nga menaxhmenti.

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se sistemi aktual i kontrolleve të brendshme nuk ofron sigurinë e mjaftueshme që ZAMV të përmbushë në mënyrë të suksesshme objektivat e saj. Gjatë punës sonë audituese ne kemi hasur dobësi në disa fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar.

- Mos përmbushje e kërkesave për raportim të jashtëm;
- Planifikimin dhe inkasimin e dobët të të hyrave vetjake;
- Mungesën e shpalosjeve të informatave për pasuritë në PVF;
- Anashkalimin e procedurave të prokurimit;
- Moskompletimin e dosjeve të tenderit; dhe
- Mosregjistrim të pasurive.

Rekomandimet tona kryesore për Zyrtaren Kryesore Ekzekutive (ZKE) janë si në vijim:

Pasqyrat vjetore financiare

- Pasuritë nën dhe mbi 1,000€ si dhe stoqet në fund të vitit duhet të shpalosen në mënyrë të plotë.

Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

- Që planifikimi i buxhetit të bëhet në baza të qëndrueshme dhe të ndërmerren masa plotësuese për grumbullimin e të hyrave;
- Të forcohen kontrollet gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit, në mënyrë që të gjitha aktivitetet e prokurimit të kryhen në pajtueshmëri me LPP; dhe
- Të regjistrohet pasuria e gjithmbarshme e cila është në pronësi të ZAMV, si dhe të kryhet azhurnimi i vazhdueshëm i regjistrit të pasurive.

Sistemi i auditimit të brendshëm

- Njësia e Auditimit të Brendshëm duhet të angazhohet më shumë për ta përmbushur planin vjetor të auditimit.

Përgjigja nga Menaxhmenti – auditimi për 2012

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe janë zotuar se do ti adresojnë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e ZAMV të përgatis PVF sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për "Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme". Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit ka reflektuar vlerësimin e rrezikut tonë të auditimit për ZAMV. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testeve të përgjithshme e që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Ne kemi përfshirë të gjeturat e rëndësishme dhe të tjera më pak të rëndësishme që dalin nga auditimi ynë. Për plotësinë ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të 9 mujorit aty ku ishte relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të rëndësishme - Çështjet kryesore për vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhmenti i lartë e që mund të ketë potencial të rezultojë në një dobësi materiale në kontrollet e brendshme; dhe

Të tjera - Dobësitë e identifikuar në auditimin tonë, ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në PVF. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave vjetore financiare. Një numër i pikëve në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

Konkluzioni i përgjithshëm

Draft PVF nuk ishin përgatitur sipas afatit të paraparë 31.01.2013. Ato ishin përgatitur me 14.02.2013 dhe nuk përfshinin të gjitha kërkesat e kërkuara sipas Rregullës Financiare nr. 07/2011, dhe SNKSP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme".

Përshkrimi

PVF duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi vërejtur se:

- PVF ishin nënshkruar nga ZKA dhe ZKF;
- PVF ishin përgatitur në formë elektronike dhe kopje fizike;
- PVF nuk ishin përgatitur brenda afatit kohorë. Ato ishin të përgatitura me 14.02.2013 dhe ishin dorëzuar në MF;
- PVF ishin pranuar vetëm në gjuhën serbe;
- Nuk ishte përpiluar dhe nuk ishte dorëzuar raporti nëntëmujorë te MF për vitin 2012; dhe
- Nuk kishte raportuar në thesar për obligimet e papaguara.

Rekomandim

Rekomandojmë menaxhmentin e ZAMV që të siguroj se gjatë përgatitjes së PVF do të përfshihen të gjitha kërkesat në pajtim me rregullën financiare, duke përfshirë edhe kërkesën që të përgatiten në të dy gjuhët.

2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare

Konkluzioni i përgjithshëm

Draft PVF-të të ZAMV të përgatitura me datë 14.02.2013 për vitin e përfunduar me 31.12.2012, nuk ishin në pajtim me Rregullën Financiare nr. 07/2011. Ato ishin jo të plota, të pasakta dhe çorientuese, prandaj në gjatë procesit të auditimit kemi kërkuar nga menxhmenti që Draft PVF të korrigjohen. Pas kërkesës sonë, përveç shpalosjeve të pasurive jo financiare pasqyrat janë korrigjuar dhe dorëzuar me 18.03.2013 në ZAP.

1. Çështja - Përgatitja e PVF – prioritet i rëndësishme

E gjetura Në shënimin 30 dhe 31: Përmbledhja e pasurive jo-financiare kapitale mbi dhe nën 1000€, zyra nuk kishte prezantuar vlerën e pasurisë;

Rreziku Një plan prodhimi jo i plotë i llogarive mund të rezultojë në PVF jo të plota ose të pasakta, me rrezikun që kërkesat statutores të mos përmbushen.

Rekomandimi 1 ZKE duhet të sigurojë që plani i prodhimit për llogaritë e vitit 2013 formalisht adreson të gjitha kërkesat për pajtueshmëri lidhur me PVF-të.

2.3 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është plotësisht i besueshëm. Regjistri i pasurive fikse nuk ka ndikim në ndonjëren prej 2 Pasqyrave Vjetore Financiare (Pranimet dhe Pagesat e Parasë së Gatshme dhe Krahasimin e Buxhetit dhe Shumat Aktuale), në pajtim me IPSAS në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme. **(SNISA: 400 Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes)**

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Zyra Administrative e Mitrovicës Veriore është formuar rishtazi si organizatë buxhatore. Ajo ka filluar me punë në Qershor të vitit 2012. Ky është auditimi i ynë i parë i PVF .

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Kjo mund, për shembull, të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrolleve operative të nivelit më ulët. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjat e llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti.

Sistemi i kontrollit të brendshëm në ZAMV kryesisht është i dobët. Kjo gjë është deri në një masë e kuptueshme, pasi që vetëm për disa muaj të funksionimit të saj është e natyrshme që kjo zyrë nuk ka mundur të vendos dhe zhvilloj një sistem adekuat të kontrollit të brendshëm. Mangësitë mund të vërehen edhe te dizajnimi i kontrollit, por edhe te zbatimi i atyre ekzistuese. Zyra ende nuk ka arritur t'i nxjerrë procedurat dhe rregullat e brendshme, në mënyrë që të qartësojë dhe thjeshtojë kryerjen e aktiviteteve operative ditore.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Konkluzioni i përgjithshëm

ZAMV ka shpenzuar vetëm 43% të buxhetit të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, por mosrealizimi i buxhetit është i arsyeshëm, duke marrë parasysh se Zyra ka filluar me punë në qershor të vitit 2012, kështu që problemet e mungesës së kuadrove si dhe shumë probleme tjera që lidhen me fazën e themelimit të administratës, kanë shkaktuar dështim në realizimin e buxhetit. Megjithatë, ZAMV po konsolidohet relativisht shpejt.

Përshkrimi

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për ZAMV dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrave të mbledhura. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme.

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (ne euro)

Përshkrimi	Buxheti i Rishikuar	Buxheti Final ¹	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi	2010 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	2,789,500	2,939,125	1,258,658	0	0
Granti i Qeverisë-Buxheti	2,779,500	2,779,500	1,258,658	0	0
Të bartura nga viti paraprak ² -	0	0	0	0	0
Të hyrat vetjake ³	10,000	10,000	0	0	0
Donacionet Vendore	0	0	0	0	0
Donacionet e Jashtme	0	149,625	0	0	0

Në bazë të të dhënave nga tabela e paraqitur mund të vërehet se buxheti përfundimtar i ZAMV dallon nga buxheti i rishikuar për 149,625€. Ky dallim është bërë për shkak të donacionit të Qeverisë norvegjeze.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (ne euro)

Përshkrimi	Buxheti i rishikuar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	2,789,500	2,939,125	1,258,658	0	-
Pagat dhe Mëditjet	1,444,655	1,444,655	857,592	0	0
Mallrat dhe Shërbimet	159,712	309,337	130,751	0	0
Komunalit	57,359	57,359	642	0	0
Subvencionet dhe Transferet	10,000	10,000	0	0	0
Investimet Kapitale	1,117,774	1,117,774	269,673	0	0

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Të hyrat vetjake të planifikuara

Në Tabelën 2 vërejmë që buxheti është shpenzuar vetëm 43%. Arsye e shkallës kaq të ultë të ekzekutimit janë problemet e shumta që janë paraqitur në fazën fillestare të themelimit.

Tabela 3. Të hyrat vetjake të planifikuara dhe realizuara (në euro)

Përshkrimi	Buxheti i rishikuar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Të hyrat vetanake	10,000	10,000	107	-	-

Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2012 kanë qenë 10,000€, por ZAMV, në periudhën qershor - dhjetor të vitit 2012, ka arritur t'i inkasoj vetëm 107€.

4.3 Kërkesat e raportimit

Konkluzioni i përgjithshëm

ZAMV nuk i ka plotësuar kërkesat e raportimit dhe nuk i është përmbajtur afateve kohore.

Përshkrimi

ZAMV nuk i ka plotësuar obligimet lidhur me raportimin e jashtëm dhe në këtë aspekt janë vërejtur mangësitë në vijim:

- Pasqyrat financiare nëntëmujore nuk ishin përgatitur;
- Plani i prokurimit nuk ishte përgatitur për shkak se ka filluar të operoj nga gjysma e vitit; dhe
- Raporti i vetëvlerësimit nuk ishte përgatitur.

Rekomandim

Ne i kemi parasysh sfidat e shumta në fazën e themelimit, por rekomandojmë Zyrtaren Kryesore Ekzekutive që për vitin 2013 të siguroj përmbushjen e kërkesave për raportim të jashtëm.

4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Konkluzion i përgjithshëm mbi të hyrat

Të hyrat vetjake të planifikuara ishin 10,000€ ndërsa ishin inkasuar vetëm 107€. Pra, kjo Zyrë ka arkëtuar vetëm 1% të të hyrave krahasuar me shumën e planifikuar.

Njësitë të cilat kanë gjeneruar të hyra vetjake janë kadastra dhe urbanizmi, dhe atë kryesisht nga lëshimi i vendimeve për leje për afarizëm, lëshimi i kopjeve të planit si dhe për legalizimin e lokaleve.

Rekomandim

ZAMV duhet të përgatitë planin e grumbullimit të të hyrave bazuar në analizat e hollësishme dhe në mundësitë reale për aplikimin e pagesave (taksave) të parapara me ligj, si dhe të aprovojë politikën e qartë dhe mekanizmat adekuat për aplikimin e arkëtimit të të hyrave vetjake të parapara me ligj.

4.5 Shpenzimet

Konkluzion i përgjithshëm mbi shpenzimet

ZAMV ende nuk ka arritur të vendosë kontrolle adekuate të shpenzimeve prej inicimit të kërkesës e deri te ekzekutimi i kontratës. Meqenëse administrata komunale ende ka sfida të shumta në ushtrimin normal të funksioneve të saj, ne e kuptojmë gjendjen e tanishme. Por, inkurajojmë Zyrtaren Kryesore Ekzekutive që të vazhdoj vendosjen e kontrolleve të duhura sipas kornizës së KBFP.

4.5.1 Prokurimi

Përshkrimi

Blerjet e kryera përmes procedurave të prokurimit për vitin 2012 kanë qenë në vlerë prej 368,603€.

Ne kemi testuar 12 kontrata (lëndë) në vlerë prej 141,389€ të cilat kanë kaluar përmes procedurave të prokurimit dhe i kemi testuar pagesat lidhur me këto kontrata. Gjatë testimit kemi vërejtur se ZAMV i ka zbatuar disa prej procedurave të prokurimit, për të cilat mund të thuhet se nuk janë plotësisht në pajtueshmëri me Ligjin mbi prokurimin.

2. Çështja - Kontrata e nënshkruar para inicimit të procesit të prokurimit - prioriteti i rëndësishëm

E gjetura Te kontrata Nr.062/2012 "Punët ndërtimore për vendosjen e trafos për ZAMV" në vlerë prej 8,935€, kontrata nr.063/2013 "Montimi i trafosë" në vlerë 9,750€ dhe kontrata nr.064/2012 "Montimi i trafos" në vlerë prej 9,370€, në tre rastet Zyra kishte nënshkruar kontratën me operatorin ekonomik para inicimit të procedurave të prokurimit. Kontrata ishte nënshkruar me datën 18.12.2012 ndërsa procesverbali i hapjes të ofertave ishte me 24.12.2012

Rreziku Nënshkrimi i kontratës para inicimit të procesit të prokurimit nuk është në pajtim me rregullat e prokurimit. Për më tepër, fillimi i punëve para kontratave, kushtëzon kontraktimin e punimeve, pavarësisht konkurrencës së tregut.

Rekomandimi 2 Zyrtarja Kryesore Ekzekutive duhet të vendos praktika që kontratat t'i nënshkruaj vetëm pasi të jenë kryer procedurat e prokurimit, duke marrë në konsideratë vlerësimin paraprak të ofertave.

3. Çështja - Mosekzistimi i dosjes së tenderit për dy operatorë ekonomik - Prioriteti i rëndësishëm

E gjetura Te kontrata "Furnizim me mobile për kabinetin e ZKA" në vlerë prej 9,750€ kemi vërejtur se ekziston vetëm dokumentacioni i tenderit të fituesit, përderi sa dosjet e tenderit të dy OE tjerë pjesëmarrës nuk ekzistojnë, edhe pse përmenden në Procesverbalin e hapjes së tenderit.

Rreziku Mangësitë e dokumentacionit në dosjet e prokurimit, rrisin rrezikun e transparencës së procesit. Nuk mund të fitohet siguria nëse operatori më i volitshëm e ka fituar kontratën.

Rekomandimi 3 Zyrtarja Kryesore Ekzekutive duhet të ndërmarrë masa për forcimin e kontrolleve administrative të prokurimit, për t'u siguruar se dosjet e prokurimit përmbajnë të gjitha dëshmitë mbi zhvillimin e procesit. Në rast se stafi i prokurimit nuk ka kompetencë të mjaftueshme profesionale, duhet t'i mundësohet ndjekja e trajnimeve në këtë fushë.

4. Çështja - Për të njëjtën prokurim, dy oferta me çmime të ndryshme nga i njëjti OE - Prioritet i rëndësishëm

E gjetura Gjatë auditimit kemi vërejtur se në dy raste i njëjti OE kishte ofertuar me nga dy oferta me çmime të ndryshme për të njëjtin prokurim. Te kontrata nr. 062/2012 "Punët ndërtimore për vendosjen e trafos për ZAMV" njëra ofertë kishte çmimin 9,525€ dhe tjetra 8,935€. Në këtë rast kontrata ishte lidhur me çmimin më të ultë.

Gjithashtu, te kontrata nr. 064/2012, "Montimi i trafos për ZAMV" në vlerë prej 9,370€, operatori fitues i kontratës kishte ofertuar me dy oferta me çmime të ndryshme. Njëra ishte në vlerë 9,700€ dhe 9,370€.

Rreziku Nënshkrimi i kontratës me OE të cilat në dokumentacionin e tyre të tenderit kanë dy oferta mund të shpie në gjykimin se procedura e tenderimit nuk është zbatuar në pajtueshmëri me kërkesat e ligjit.

Rekomandimi 4 Zyrtarja Kryesore Ekzekutive duhet të sigurohet se procesi i prokurimit zhvillohet vetëm në bazë të kërkesave specifike të rregullave të prokurimit, është i qartë dhe eviton mundësinë e dyshimeve në proces. Specifikimi i saktë i çmimit në ofertë është një nga kërkesat parësore të vlerësimit.

5. Çështja - Dokumentacioni i tenderit pjesërisht i plotësuar dhe i panënshkruar - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Disa mangëis janë vërejtur te kontratat në vijim:

- “Furnizim me dhurata për fundvit për fëmijë të komuniteteve të ndryshme” në vlerë 9,350€,
- “Furnizim me dru për nevojat të skamnorëve të komuniteteve të ndryshme” në vlerë 9,900€; dhe
- “Furnizim me notesë dhe kalendarë” në vlerë 9,800€.

Në këto raste dokumentacioni tenderues është jo i plotë, për shkak se regjistri i pranimit të tenderëve ishte i pa nënshkruar nga operatorët ekonomik, si dhe vlerësimi i ofertave në tre raste ishte bërë në të njëjtën datë nga i njëjti komision vlerësues. Po ashtu, kemi vërejtur se 18 kontrata ishin nënshkruar me 18.12.2012.

Rreziku Kontratat u janë dhënë ofertuesve pa asnjë shpjegim të vlefshëm, në të njëjtën ditë. Vlerësimet nga i njëjti komision dhe të kryera në të njëjtën ditë janë vetëm plotësim i aspektit formal, por jo edhe i aspektit cilësorë të procesit. Mungesa e nënshkrimit të operatorëve, vë në dyshim pjesëmarrjen e tyre në proces.

Rekomandimi 5 Dështimi i ndjekjes së procedurave të duhura të prokurimit dhe udhëzimet shoqëruese, ka rezultuar me pagesa potencialisht të parregullta dhe humbje financiare për ZAMV. Ekziston rreziku i mëtejme se është arritur vlerë e dobët për paranë e shpenzuar në këto kontrata.

4.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Buxheti për paga dhe mëditje për vitin 2012 ka qenë në vlerë prej 1,444,655€, kurse janë shpenzuar 857,591€ ose 59%. Niveli i ulët i realizimit të buxhetit në këtë kategori shpjegohet me faktin se ZAMV nuk ka arrit t'i kryej rekrutimet e planifikuara.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat që operohen në nivel lokal nga ana e ZAMV kanë të bëjnë me a) kontrollimi i pagimit të pagave për çdo muaj me anë të nënshkrimit të listave të pagave; b) miratimi i ndryshimeve të mundshme të

cilat mund të paraqiten përmes formularëve; c) shqyrtimi i buxhetit për këtë kategori dhe harmonizimi me trezorin.

Për këtë kategori i kemi testuar 38 mostra me ç'rast kemi kontrolluar nëse shuma e pagave nga lista e pagave përputhet me kontrata dhe me payroll. Pastaj, nëse lartësia e shumës është në pajtueshmëri me koeficientin e paraparë me ligj për përshkrimin e punës së caktuar, apo për vendin e caktuar të punës. Kemi konstatuar se rastet e përmendura janë në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

6. Çështja - Të Dhënat e Personelit - Prioriteti - i rëndësishëm

E gjetura Shqyrtimi i Dosjeve të Personelit identifikoi se në dosje mungon dokumentacioni në vijim: raportet mbi vlerësimin, dëshmitë për përgatitjen profesionale dhe përvoja në punë, përshkrimi i vendit të punës.

Rreziku Të dhënat nuk janë në dispozicion për ta justifikuar rregullsinë e pranimit të stafit, shkathtësitë e tyre profesionale dhe identifikimin e nevojave për trajnime.

Rekomandimi 6 Zyrtarja Kryesore Ekzekutive duhet të bëjë një shqyrtim sistematik të Dosjeve të Personelit, për të siguruar se i tërë dokumentacioni i nevojshëm është përfshirë, brenda një periudhe të specifikuar kohore. Gjithashtu, duhet të ndërmerren masa që lidhur me nënshkrimin e listave të pagave.

4.6 Pasuritë

Konkluzioni i përgjithshëm mbi pasuritë

ZAMV kishte iniciuar procesin e regjistrimit të pasurive të saj në regjistrat kontabël, por ky proces duhet të vazhdohet deri në regjistrimin e plotë të pasurive në regjistrat e pasurive dhe SIMFK. ZAMV duhet të themelojë komisionin për vlerësimin dhe regjistrimin e pasurive, si dhe të emëroj zyrtarin për pasuri.

4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Ne kemi vërejtur se ZAMV nuk ka të emëruar zyrtarin për pasuri. Ajo ka zyrtarin e logjistikës, por sipas skemës organizative ai është edhe shef i logjistikës/voztës. Kështu që

ai nuk ka evidencë lidhur me pranimin dhe disponimin e pasurisë. Po ashtu nuk e ka as regjistrin e stoqeve.

ZAMV ende nuk ka filluar të regjistroj pasurinë e vet në SIMFK. Ne inkurajojmë ZAMV-në, që pas emërimit të zyrtarit për pasuri, të filloj edhe me regjistrimet e duhura në SIMFK.

4.7 Trajtimi i borxheve

Konkluzioni i përgjithshëm mbi trajtimin e borxheve

ZAMV nuk ka raportuar borxhe (fatura) të pa paguara në fund të vitit në MF, ndonëse ne kemi hasur një shumë të vogël të detyrimeve të tilla.

Përshkrimi

Pas rishikimeve tona, ne kemi vërejtur se Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2012 ishte 3,093€. Këto detyrime janë bartur për pagim në vitin fiskal 2013 dhe kanë të bëjnë me detyrimet e krijuara me prokurim të mallrave dhe shërbimeve. Arsyeja pse këto detyrime kanë mbetur të papaguara ishte vonesa në dorëzimin e faturave në muajin dhjetor 2012.

5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Konkluzion i përgjithshëm mbi sistemin e auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm ka filluar me punë në gjysmën e dytë të vitit 2012. Auditori i brendshëm kishte kryer vetëm një auditim gjatë vitit 2012. Edhe pse rishtazi e themeluar si njësi, auditori i brendshëm ka treguar një përkushtim të madh në fushën e rishikimit të kontrolleve të brendshme, si dhe ngritjen e cilësisë dhe efektivitetit të kontrolleve.

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm dhe për shkak të rëndësisë së tij ne e prezantojmë këtu ndaras. Ne e marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit. Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë, si rezultat i punës së kryer nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit.

ZAMV-ja e ka të emëruar një auditor të brendshëm, i cili njëkohësisht edhe drejtor i AB. NjAB-ja nuk kishte hartuar një plan strategjik. Për shkak të kohëzgjatjes së shkurtër të veprimit, ne nuk jemi në gjendje të nxjerrim konkluzionet përfundimtare mbi cilësinë e këtij funksioni, por ajo që mund të thuhet është fakti se auditori i brendshëm është mjaft i përkushtuar në përmbushjen e funksionit të tij. Megjithatë, ai duhet të ndjekë trajnimet nga kjo fushë, për të qenë i aftë të kryej punën e tij në pajtim me standardet e kërkuara.

6 Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni jonë i përgjithshëm e pasqyron rishikimin tonë të kontrolleve të ndërlidhura me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe të Sistemit të Auditimit të Brendshëm.

Bazuar në gjetjet e këtij raporti, vijmë në përfundim se menaxhmenti përgjegjës ende nuk kishte arritur të vendos kontrolle funksionale që do të siguronin menaxhim efektiv të organizatës. Mangësitë menaxheriale janë shprehur në ekzekutimin e buxhetit, që ka ardhur si rezultat i mos rekrutimit të duhur të stafit dhe mos planifikimit dhe zbatimit të duhur të blerjeve përmes prokurimeve. Në veçanti, dobësitë vërehen sidomos në të kuptuarit e procedurave e prokurimit, të cilat nuk ishin zhvilluar në pajtim të plotë me kornizën e aplikueshme ligjore, përgatitja e dobët e dosjeve të personelit, mungesa e regjistrimit të pasurive dhe prezantimit të tyre në pasqyra financiare.

Menaxhmenti duhet të ketë të qartë kornizën e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike dhe t'i bëjë të ditur tërë stafit kërkesat e këtij dokumenti. Vetëdija për nevojën e kontrolleve, duhet të zhvillohet në mënyrë permanente.

ZAMV po bën hapat e parë të vendosjes së administrimit me resurset e saj. Vështirësitë e themelimit deri në konsolidimin e plotë të Departamenteve administrative, vazhdojnë edhe më tutje. Stafi aktual nuk është mjaft i përgatitur për tu përballur me sfidat e përditshme. Mungesa e shkathtësive dhe njohurive për punë, ka reflektuar edhe në gabimet dhe parregullsitë e identifikuarra më lart. Identifikimi i fushave për trajnimin e stafit, mbetet detyrë e menjëhershme.

Auditori i brendshëm duhet të bashkëpunoj ngushtë me NJQH/AB, për të fituar përvojat dhe asistencën profesionale të kësaj njësie. Po ashtu, edhe bashkëpunimi me NJAB të komunave tjera, do të ndihmonte në ngritjen e kapaciteteve të tij.

Të gjitha këto shpijnë në konkluzionin se menaxhmenti i ZAMV duhet të bëjë përpjekje serioze për t'i eliminuar mangësitë e identifikuarra dhe për ta ndërtuar një administratë efektive komunale.

Ne rekomandojmë Zyrtaren Kryesore Ekzekutive që:

Të nxjerrë një pako Vendimesh, Udhëzime, politika të shkruara dhe procedura të cilat do të përbënin bazën e mjaftueshme ligjore për të realizuar objektivat e saj, performancën operative dhe sistemet e kontrollit të brendshëm. Shfrytëzimi i modeleve dhe përvojave të komunave me shumë vite traditë dhe praktika të mira, do të ishte një ndihmesë e madhe për menaxhmentin e ZAMV.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një **opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinion i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinionin e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinion i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.